



Albanian Chess Federation

Rr. "Liman Kaba " Ish-Kompleksi Dinamo, Tirane

<http://www.durres2018.com/>

1. Ftesë Zyrtare

Ftesë zyrtare për të gjithë Federatat Anëtare të FIDE dhe lojtarët e tyre, për të marrë pjesë në Kampionatin Botëror të Shkollave në Shahu 2018 (në kategoritë për djemtë / i hapur dhe vajzat Nën 7, 9, 11, 13, 15 dhe 17 vjeç). Kampionati do të mbahet në Durrës - Shqipëri, në bregdetin e Adriatikut, nga data 20 deri më 29 Prill 2018, nën patronazhin e Federatës Botërore të Shahut

(FIDE) dhe Federatës Shqiptare të Shahut(FSHSH).

2. Salla e Lojrave

Lojërat do të zhvillohen në sallën e konferencave të hotelit me 4 yje "FAFA Resort" në Durrës, 40 km në jugperëndim të aeroportit të Tiranës, një resort i shkëlqyer në brigjet e ujëravë të kristalta të detit Adriatik.

3. Programi I Turneut

E Premte	20 Prill	Gjithë Ditën	Mbërritja E Pjesëmarrësve
E Shtunë	21 Prill	11:00	Mbledhje Teknike
E Shtunë	21 Prill	14:30	Ceremonia E Hapjes
E Shtunë	21 Prill	15:00	Raundi 1
E Dielë	22 Prill	15:00	Raundi 2
E Hënë	23 Prill	15:00	Raundi 3
E Martë	24 Prill	15:00	Raundi 4
E Mërkurë	25 Prill	15:00	Raundi 5
E Enjte	26 Prill	15:00	Raundi 6
E Premte	27 Prill	15:00	Raundi 7
E Shtunë	28 Prill	15:00	Raundi 8
E Dielë	29 Prill	10:00	Raundi 9
E Dielë	29 Prill	16:00	Ceremonia E Mbylljes
E Dielë	29 Prill	Mbasdite	Nisja



Albanian Chess Federation

Rr. "Liman Kaba " Ish-Kompleksi Dinamo, Tirane

<http://www.durres2018.com/>

4. Rregullore Teknike

4.1. Do të aplikohet sistemi zviceran i vlerësimit i FIDE me 9 raunde. Rregullorja e Përgjithshme e Garave të FIDE, do të aplikohet përgjatë gjithë kampionatit.

Do të marrin pjesë 6 kategori: U-07, U-09, U-11, U-13, U-15, U-17, të ndarë këto në evente për djem dhe vajza (në total 12 kampionate). Të drejtën për pjesëmarrje në çdo kategori e gëzojnë:

Nën 07: Lojtarë të lindur në/pas 1 Janar 2011,

Nën 09: Lojtarë të lindur në/pas 1 Janar 2009,

Nën 11: Lojtarë të lindur në/pas 1 Janar 2007,

Nën 13: Lojtarë të lindur në/pas 1 Janar 2005,

Nën 15: Lojtarë të lindur në/pas 1 Janar 2003,

Nën 17: Lojtarë të lindur në/pas 1 Janar 2001

4.2. Federatat anëtare të FIDE dhe Akademitë e Shahut të miratuara nga FIDE gëzojnë të drejtën të dërgojnë sa lojtarë të dëshirojnë, të regjistruar vetëm nëpërmjet Federatës Kombëtare

4.3. Lojtarët me të drejta personale të kualifikimit, referuar manualit të FIDE D. 04.08 neni 4, fitojnë të drejtën e akomodimit falas në një dhomë dyshe.

4.4. Koha e përcaktuar për lojtar: 90 minuta për 40 lëvizje + 30 minuta për pjesën tjetër të ndeshjes + 30 sekonda shtesë për çdo lëvizje, duke nisur nga lëvizja e parë. Lojtari e humb lojën nëse nuk paraqitet në tavolinën e tij brenda një ore nga fillimi i lojës.

4.5. Renditja finale e lojtarëve përcaktohet nga numri i pikëve të shënuara/grumbulluara. Nëse dy apo më shumë lojtarë janë në barazim për vendin e parë apo për çdo çmim tjetër, atëherë ky barazim do të thyhet duke ndjekur rregullat në vijim:.

- a. Numërim direkt i pikëve (aplikohet vetëm nëse të gjithë lojtarët kanë luajtur me njëri-tjetrin)
- b. Buchholz Cut 1
- c. Buchholz
- d. Numri më i madh i fitoreve me gurë të zinj
- e. Numri më i madh i fitoreve



Albanian Chess Federation

Rr."Liman Kaba " Ish-Kompleksi Dinamo, Tirane

<http://www.durres2018.com/>

5. Çmimet, Titujt, Çertifikatat

5.1. Organizatori do të nderojë me trofe lojtarët që marrin tre vendet e para në çdo event. Organizatori gjithashtu do të nderojë me medalje Ari, Argjendi dhe Bronzi, lojtarët e tre vendeve të para në çdo event. Trofetë për vendin e parë dhe medaljet do të jepen pasi të jetë aplikuar thyerja e barazimit.

5.2. Për kategoritë U-13, U-15, U-17, që perfundojnë me first equal deri në 3 lojtarë do t'u akordohet titulli FM/WFM. Fituesit e medaljeve të Argjendit dhe Bronzit do të nderohen me titullin CM/WCM. **Titujt do jepen sipas kushteve që përcakton rregullorja e FIDE.**

5.3. Për kategoritë U-07, U-09, U-11, që perfundojnë me first equal deri në 3 lojtarë fitues të medaljeve të Argjendit dhe Bronzit do të nderohen me titullin CM/WCM. **Titujt do jepen sipas kushteve që përcakton rregullorja e FIDE.**

5.4. Lojtarët të cilët klasifikohen në 3 pozicionet e para, vlerësohen me çertifikatë

5.5. Të gjithë pjesëmarrësit do të pajisen me Çertifikatë Pjesëmarrje, përfshirë lojtarët, trajnerët e akredituar nga FIDE, menaxherët dhe teknikët zyrtarë të caktuar nga FIDE

6. Komiteti I Apelimit dhe Proçedurat e Apelimit

6.1. Komiteti I Apelimit do të jetë I përbërë nga 3 persona, një nga të cilët duhet të jetë Delegat Teknik I FIDE. Nëse Komiteti I Apelimit është caktuar nga Mbledhja Teknike, do të ketë 2 anëtarë shtesë dhe në këtë rast, asnjë nga këta anëtarë nuk do të marrë pjesë në vendime që prekin lojtarë të federatës përkatëse.

6.2. Nje ankese kundrejt vendimit të një arbitri duhet të dorëzohet tek Arbitri kryesor, brenda një ore nga mbarimi I lojës.

6.3. Tarifa për ankimimin, e pagueshme për FIDE, është 200 Euro dhe është e kthyeshme nëse ankesa mbështetet. Komiteti I Apelimit mund gjithashtu të vendosë të rimbursojë tarifën, nëse konsideron se apelimi ka qenë I pavlefshëm.

6.4. Vendimi I Komitetit të Apelit është përfundimtar, detyrues dhe me efekt të menjëhershëm.



Albanian Chess Federation

Rr. "Liman Kaba " Ish-Kompleksi Dinamo, Tirane

<http://www.durres2018.com/>

7. Tarifa e Hyrjes FIDE

Autoriteti Organizator do të sponsorizojë dhe paguajë direct pranë FIDE tarifën hyrëse prej **40 Euro** për të gjithë lojtarët të cilët do të akomodohen në hotelin e përcaktuar zyrtarisht, ofertat e përshkruara të të cilit I gjeni në artikullin 8.1. Kjo është e vetmja tarifë regjistrimi apo hyrje.

8. Paketat e akomodimit

8.1. Sipas rregullores së FIDE, të gjithë lojtarët dhe personat shoqërues duhet të jenë të akredituar dhe do të qëndrojnë në hotelin I cili është përcaktuar zyrtarisht për eventin. Rezervimet dhe akreditimet e tyre, mundësohen vetëm sipas procedurës së përhkruar në artikujt 8.1. dhe 9.2 (përfshin akomodimin për 9 netë për person, mëngjesin, drekën dhe darkën, përdorimi I pishinës së hotelit dhe plazhit privat, transportin nga/për në aeroportin e Tiranës, certifikatat, dhe të gjitha tarifat e taksat).

Hoteli me 4 yje "FAFA RESORT"

Tarifa /person: 490 €/ total në dhomë treshe për 9 netë, tre vakte të përfshira dhe gjithçka e përmendur në artikullin 8.1.

Tarifa/person: 535 € në dhomë dyshe për 9 netë, tre vakte të përfshira dhe gjithçka e përmendur në artikullin 8.1.

Tarifa/person: 750 € në dhomë teke për 9 netë, tre vakte të përfshira dhe gjithçka e përmendur në artikullin 8.1.

8.2. Gjithashtu shtojmë se lojtarëve të cilët kanë të drejtat e përmendura në artikullin 4.3., Autoriteti Organizator iu ofron akomodim pa pagesë për 9 netë në dhomë dyshe shoqëruar nga një person për federatë që ka të paktën 6 lojtarë pjesëmarrës. Personi shoqërues duhet të ketë një licencë të vlefshme si Trainer I FIDE për të përfituar nga kjo ofertë.

8.3. Netët shtesë mundësohen sipas kërkesës dhe në një zbritje proporcionale. Hoteli gjendet në të njëjtin resort me sallën e lojërave. Ofertat e mëposhtëme janë të garantuara vetëm për regjistrime dhe rezervime deri më datë 20 Shkurt. Pas kësaj date dhomat mund të ofrohen me një kosto të rritur dhe vetëm në varësi të disponueshmërisë.



Albanian Chess Federation

Rr."Liman Kaba " Ish-Kompleksi Dinamo, Tirane

<http://www.durres2018.com/>

9. Proçedura e regjistrimit, vizat dhe afatet

9.1. Duke nisur nga data 20 Shkurt 2018, Federatat Kombëtare pjesëmarrëse do të dorëzojnë regjistrimet e pjesëmarrësve në adresën elektronike: info@durres2018.com. Të gjithë regjistrimet duhet të përmbajnë emrin e plotë, klasifikimin, personin shoqërues, llojin e akomodimit, datat e mbërritjes/nisjes dhe faturën e transfertës bankare. Të gjitha regjistrimet duhet të jenë të konfirmuara nga Drejtori I Turneut dhe gjithashtu dhomat do të rezervohen pasi të jetë depozituar 50% e vlerës totale nga 20 Shkurti në llogarinë e agjensisë organizuese të eventeve për hotelin.

9.2. Datëlindja e çdo lojtari duhet të jepet dhe duhet të korrespondojë me datëlindjen e dhënë në pasaportë apo në çfarëdo dokumenti udhëtimi. Të gjitha dokumentat e udhëtimit duhet gjithashtu të paraqiten të paktën 2 muaj para nisjes së eventit, kjo për rastet kur është e nevojshme lëshimi I vizës. Autoriteti Organizator nuk mban asnjë përgjegjësi për paraqitje të vonuara të dokumenteve dhe aplikimeve për vizë.

10. Fluturimet/ Transporti nga/për Aeroporti

Aeroporti më i afërt është ai I Tiranës (Kodi IATA: TIA), rreth 40 km nga vendi ku organizohet eventit. Autoriteti Organizator do të ofrojë transportin në mbërritjen dhe përcjelljen e pjesëmarrësve nga Aeroporti në FaFa Resort Hotel e kthim, për të gjithë ata të regjistruar sipas artikullit 8.1 pa tarifë extra.

11. Seminaret

Seminaret për Mësuesit e Shkollave të Shahut, Arbitrat dhe Trainerët do të mbahen nga datat 27 deri më 29 Prill 2018.

12. Kontaktet

Drejtori I Turneut & Organizatori Ndërkombëtar I FIDE, Mr.Nikos Kalesis
(nikoskalesis@gmail.com)

Menaxheri I Turneut & Sekretare e Përgjithshme e Federatës Shqiptare të Shahut , Mrs.Majlinda Pilinci (pilincimajlinda@gmail.com)

Email:info@durres2018.com

Website Zyrtar: www.durres2018.com



Albanian Chess Federation
Rr. "Liman Kaba " Ish-Kompleksi Dinamo, Tirane

<http://www.durres2018.com/>

